

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA  
 QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA  
 MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR  
 MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA  
 MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING

Njësia Org. SP-02 Nr Prot. 7148-2/18  
 Org. Jedinica Org. Unit Prot. Prot. No.  
 Nr. i faqeve 03 Data: 04.10.19  
 Broj. stranica No pages Date: / / 20  
 Prishtinë / a



**Republika e Kosovës**  
 Republika Kosova - Republic of Kosovo  
 Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor*  
*Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja*  
*Ministry of Environment and Spatial Planning*

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary*

<b>DATË/A:</b>	03.10.2019
<b>REFERENC-Ë:</b>	18/7148/858/DMMU
<b>PËR/ZA/TO:</b>	"LIRIMI L&B" SH.P.K. Rahovec Qendër grumbulluese të mbeturinave metalike dhe komponentëve të tyre në Rahovec
<b>CC:</b>	
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Z. Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Vendim për Leje Mjedisore

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të kompanisë "LIRIMI L&B" SH.P.K. Rahovec, me nr. prot. 18/7148/858/DMMU, të datës 03.12.2018.

MMPH pas shqyrtimit të kërkesës të lartcekur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, bien vendimin i cili i bashkëngjitet kësaj letërpërcjellëse së bashku me Shtojcën:

- Vendimi për refuzim të kërkesës për Leje Mjedisore për "LIRIMI L&B" SH.P.K. Rahovec, për qendrën grumbulluese të mbeturinave metalike dhe komponentëve të tyre në Rahovec.
- Shtojcë: Obligimet dhe detyrimet që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 dhe Udhëzimi Administrativ për Leje Mjedisore Nr. 07/2017.

Me respekt,

Faqe 1 nga 3



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor*  
*Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja*  
*Ministry of Environment and Spatial Planning*

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary*

Në bazë të nenit 31, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025 dhe Udhëzimit Administrativ për Leje Mjedisore nr. 07/2017, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, bie këtë:

**V E N D I M**

**Refuzim i kërkesës për Leje Mjedisore**

Kompanisë "LIRIMI L&B" SH.P.K. Rahovec, për qendrën grumbulluese të mbeturinave metalike dhe komponentëve të tyre në Rahovec.

**A r s y e t i m**

Pas shqyrtimit të kërkesës për tu pajisur me Leje Mjedisore të kompanisë "LIRIMI L&B" SH.P.K. Rahovec, për qendrën grumbulluese të mbeturinave metalike dhe komponentëve të tyre në ngastrën kadastrale nr. P- 71813053-04581-1, me sipërfaqe 3432 m<sup>2</sup>, zona kadastrale Rahovec, komisioni për Leje Mjedisore pas realizimit të vizitës në terën ka kërkuar nga kompania që të plotësoj informata shtesë.

Mungojnë:

- Fletët përcjellëse të Vendimit të pëlqimit Mjedisor;
- Certifikatë e përdorimit (të objektit) nga Komuna;
- Pikat: 2.1.1, 2.1.2, 4.1, 5.1.5, kapitulli 6. dhe 7, si dhe pika 8.1.2 në aplikacion nuk janë plotësua në përputhje me pyetjet në aplikacion dhe gjendjen në terën;

Faqe 2 nga 3



- Sqarim lidhur me nxjerrjen e acidit sulfurik nga bateritë, nuk është bërë në përputhje me gjendjen në terën;
- Pjesët që kanë përmbajtje të vajrave nuk janë vendosur në hapësirë të betonuar (izoluar) dhe mbuluar;
- Mbeturinat nuk janë të klasifikuara sipas llojit të mbeturinave, mungojnë tabelat me mbishkrim të llojit mbeturin të vendosura të çdo lloj grupi i mbeturinave.

Pasi që kompania në fjalë nuk i ka sjell informatat shtesë të cekura me lartë, nuk janë përmbush kushtet teknike dhe mjedisore, dhe ka mungesë të dokumentacionit, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, merr vendim për **Refuzimin e kërkesës për Leje Mjedisore** të kompanisë "LIRIMI L&B" SH.P.K. Rahovec, për qendrën grumbulluese të mbeturinave metalike dhe komponentëve të tyre në Rahovec.

**Shpjegim për palën:** Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për ri aplikim sipas procedurës së rregullt.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes së tij.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 18/7148/ZSP/470/19 datë: 03.10.2019.

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komunës
3. DMMU-së
4. Inspektoratit
5. Kabinetit të Ministrit
6. Arkivit të MMPH-së

  
 Arben ÇITAKU  
 Sekretar i Përgjithshëm

Faqe 3 nga 3